



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

**SHPLLJE VETËM PËR NËPUNËS CIVILË
PËR PRANIM NË POZICION TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES**

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Kreut VIII dhe IX të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së i ndryshuar, Instituti i Statistikave (INSTAT) shpall procedurat e konkurimit për pozicionin:

Drejtore i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit – kategoria II-a.

Pozicioni i mësipërm është i hapur për nëpunësit civil të kategorisë së mesme drejtuese të shërbimit civil (kategoria II-b).

**DATA E FUNDIT E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR APLIKIM
ËSHTË DATA 26.07.2021**

1. Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Drejtore i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit, është si më poshtë:

Përgjegjës për sigurimin me mbështetje në kohë me personel dhe bazë materiale për drejtorinë e institucionit, të hartojë politika për zhvillimin e Burimeve Njerëzore, menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe të monitorojë koordinimin dhe menaxhimin e Projekteve, që institucioni përfiton nga bashkëpunimi statistikor me donatorë të huaj, të cilat mbështesin aktivitetet statistikore bazuar në nevojat e INSTAT sipas Programit të Statistikave Zyrtare. Më konkretisht ka përgjegjësinë:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Të asistojë Drejtorin e Përgjithshëm në menaxhimin e shërbimeve mbështetëse me efektivitet dhe eficiencë;
- Të menaxhojë dhe koordinojë në mënyrë të qendëruar dhe funksionale planifikimin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër, dhe çështjet ligjore;
- Të sigurojë një funksionim efektiv të rrjetit të komunikimit midis institucioneve përgjegjëse të Sistemit Kombëtar Statistikor;
- Të garantojë zbatimin e procedurave në përputhje me rregullat e menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Të koordinojë dhe bashkërendojë në mënyrë eficiente projektet në mbështetje të prodhimit statistikor, infrastrukturës dhe komunikimit;
- Të rritë eficiencën e komunikimit të statistikave zyrtare dhe shpërndarjen e informacionit.

2. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese të shërbimit civil (kategoria II-b).
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë vlerësimin e fundit shumë mirë ose mirë.
- Të mos kenë proçese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proçes, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

3. Kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master profesional” të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në shkenca Ekonomike. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).*
- Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vite në profesion;
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë në Administratën Publike nga të cilat të paktën 2 vite në nivel të mesëm drejtues (kategoria II-b).
- Të ketë njohuri mbi standartet e kontabilitetit.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

4. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati I Dorëzimit:

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Zyrës së Protokollit në Institutin e Statistikave dokumentat si më poshtë vijon:

- a) Kërkesë për aplikim për vendin vakant, një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive për komunikim;
- b) Jetëshkrimi;
- c) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- d) Fotokopje e Diplomës;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejt në Institutin e Statistikave brenda dates 26.07.2021.

5. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi I afatit të aplikimit, Njësia Përgjegjëse në Institutin e Statistikave do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe në datën **05.08.2021** do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Instutucionit të INSTAT (www.instat.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar do të njoftohen me e-mail nga Njësia Përgjegjëse në Institutin e Statistikave dhe kanë të drejtë të paraqiten prane saj për t'u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia Përgjegjëse në Institutin e Statistikave do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

6. Fusha e njohurive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët:

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin Drejtor I Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit, do të vlerësohen në lidhje me:

9. Njohuri për:

- Ligji nr.76/2016 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, I ndryshuar;
- Ligji nr. 140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe të Banesave”;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, I ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës publike (ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij, ligji nr. 9000, datë 30/01/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”);
- Detyrimet e Shqipërisë për aderimin në BE; Institucionet e BE;
- Kuadrin legjislativ dhe rregullator mbi IPA II:
(http://dap.gov.al/Ligj_37_2015_09.04.2015.pdf,
http://dap.gov.al/Vendim%20i%20KM_541_18.06.2015.pdf);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Kodin e Procedurave Administrative;
- Legjislacionin e prokurimit publik;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor (ligji nr. 9936, datë 26/06/2008);
- Legjislacionin për rregullat e etikës në administratën publike (ligji nr. 9131, date 08/09/2003).

B. Aftësitë për të:

- Menaxhuar situata emergjente.
- Menaxhuar situata, të cilat nuk kanë qënë të parashikuara
- Marrë vendime mbi bazën e argumentave;
- Shprehur opinion dhe argumenta në mënyrë të rrjedhshme dhe të sjellshme;
- Respektuar të tjerët (kolegët, vartësit, qytetarët) dhe dëgjuar opinionet e tyre;
- Bashkëpunuar me kolegët, duke ndarë me ta informacionin dhe njohuritë e nevojshme;
- Komunikuar procesin e vendimmarrjes bazuar në argumenta dhe analizë të pasojave;
- Ndërmarrë nisma të ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kompetencave të funksionit me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, përmbushjen e objektivave dhe përcaktimin e rrugëve dhe hartimin e planeve për mënjanimin e risqeve në realizimin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore dhe materiale me kosto sa më të ulët dhe me rendiment maksimal;
- Krijuar procedura apo politika të reja;
- Ndryshuar procedura apo politika ekzistuese në mënyre inovative;
- Menaxhuar dhe inkurajuar skuadrën për të zhvilluar ide të reja;

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Faza e konkurimit konsiston në:

- a) Vlerësimin e Jetëshkrimit (CV) të kandidatëve që përfshin vlerësimin e arsimimit, 5 eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore - 10 pikë

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- b) Testimi me shkrim – 40 pikë
- c) Intervista e striktuar me gojë – 50 pikë

Testimi me shkrim dhe intervista me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, të aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën e kompetencës si më lart.

8. Data e zhvillimit të konkurimit:

Konkursi do të zhvillohet në datën **26.08.2021**, në ambientet e Institutit të Statistikave, në adresën: Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tiranë.

9. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse në Institutin e Statistikave do të shpallë në datën **13.09.2021** fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (www.instat.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë Institucionit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042233356, ose në adresën: Instituti i Statistikave, “Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al